



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike,
Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm**

Nr. 454/9 Prot.

Tiranë, më 30/09/ 2016

V E N D I M

Nr. 132, datë 30.09.2016

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT NË BANKËN E
SHQIPËRISË ME OBJEKT “VLERËSIMI I AKTIVITETIT
EKONOMIKO - FINANCIAR, ZBATIMI I BUXHETIT TË BANKËS SË
SHQIPËRISË, DHE RREGULLSHMËRIA E ZHVILLIMIT TË
ANKANDEVE TË BONOVE TË THESARIT E OBLIGACIONEVE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit ku jepet një pasqyrë e ecurisë së treguesve kryesore të aktivitetit ekonomik financiar, përpjekjet dhe reformat të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të plotësisë së një kuadri ligjor sa më të plotë për menaxhimin dhe drejtimin veprimtarisë së institucionit, si në rastin e përmirësimit nga ana e Këshillit Mbikëqyrës të mbi 15 rregulloreve për rregullimin e veprimtarisë së Departamentit të Emisionit, gjithsesi gjykojmë se, në vlerësim të konstatimeve dhe të projektvendimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit të Performancës dhe Drejtori i Përgjithshëm, mendojmë se duhet të ndërmerren dhe masa të tjera në konsolidimin e kësaj rruge. Në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit: *“Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik-financiar, zbatimin e buxhetit të Bankës së Shqipërisë, dhe rregullshmëria e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit e obligacioneve”*, për periudhën 01.01.2015 deri më 31.12.2015

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACION

1. Në mënyrë të vazhdueshme por edhe të kujdesshme kemi rekomanduar dhe kemi kërkuar vëmendje të shtuar lidhur me ndërhyrjet që janë të domosdoshme të bëhen në lidhje me amendimet në Ligjin nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndërhyrje që jo vetëm të sillnin një përafrim me kërkesat e Bankës Qendrore Europiane, por duhet të marrin në konsideratë edhe aspektet dhe kontekstin ku do të implementohet ky ligj. Me gjithë qëndrimin hezitues ndaj rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, konstatohet se gjatë kësaj periudhe për rregullimin e veprimtarisë së Departamentit të Emisionit, Banka e Shqipërisë ka marrë masa duke miratuar për rregullimin e këtij procesi 15 Vendime të Këshillit Mbikëqyrës. Megjithatë gjykojmë se është i nevojshëm hartimi i një manuali të plotë (një kornizë rregullative) të konsoliduar, duke marrë më të mirën e bazës aktuale për të përmirësuar kryesisht aspektet e kontrollit dhe vënies në efikasitet të mekanizmave kontrollues, aq të cënueshëm deri pak kohë më parë, me qëllim edhe për të konfirmuar *gatishmërinë dhe përpjekjet që po bëhen në drejtim të përmirësimeve të nevojshme të legjislativës që rregullon funksionimin e Bankës Qendrore, por në respektim të pavarësive të saj. Në planin e masave të aprovuar për vitin 2016 nga SAFEGUARD, (FMN) është parashikuar që propozimet për ndryshimet ligjore do të paraqiten pranë Kuvendit të Shqipërisë si institucioni ligjvënës i ngarkuar nga Kushtetuta për të realizuar veprimtarinë legjislative në Republikën e Shqipërisë brenda vitit 2016, megjithatë deri në fund të këtij auditimi konstatuam se propozimet për ndryshime ligjore nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Ekonomisë, por edhe nuk janë hedhur në diskutim në grupe interesi dhe ekspertë të fushës, proces vendimtar për një praktikë legjislative të suksesshme dhe të qëndrueshme. Nga Banka është parashikuar të realizohet një proces gjithëpërfshirës duke filluar që nga bashkëpunimi me institucionet financiare ndërkombëtare dhe deri në konsultime të ngushta me organet më të larta ekzekutive dhe legjislative në vend, por grupet që do të përfshihen në këtë proces të programojnë afate konkrete për të mundësuar ndjekjen e realizimit të kësaj iniciative ligjore, *trajtuar më hollësisht në faqet 4-6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga ana e Bankës realizimi i ndryshimeve ligjore të realizohet përmes një komunikimi më të hapur me aktorë të rëndësishëm të fushës bankare në vend, në mënyrë që oponenca të ndikojë në rritjen e nivelit të iniciativës ligjore dhe të garantojë jetëgjatësi të këtij Ligji. Duke vlerësuar maksimalisht iniciativën, inkurajojmë realizimin në një afat sa më optimal të këtij procesi i cili duhet të programojë edhe diskutime paraprake në konsultim dhe në mbikëqyrjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Në referenca të konstatimeve të auditimit të realizuar me objekt “Auditimin e përputhshmërisë së administrimit të fondeve logjistike në Departamentin e Emisionit me kuadrin rregullator në fuqi”, për periudhën 01.01.2010 deri më 31.07.2014, si dhe vlerësimit të Raportit Përfundimtar dhe të dhënave të paraqitura nga shoqëria audituese “K A” Shpk, e kontraktuar për auditimin e pasqyrave financiare të mbylljes së aktivitetit ekonomik-financiar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2015, ku gjejmë problematika të lidhura me të njëjtin objekt për të cilin audituesi shprehet “... *Ne identifikuam disa çështje në lidhje me procedurat e kontrollit mbi paranë, që kërkojnë përmirësime të mëtejshme...*”, grupi i auditimit të KLSH-së, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400 “Parimet themelore të

auditimit të përputhshmërisë, ISSAI 1500 “Evidencat e Auditimit” dhe ISSAI 1620 “Përdorimi i punës së një eksperti auditimi”, cilëson problematikat si më poshtë:

-Mungesën e një sistemi të kompjuterizuar regjistrimi të parave dhe përdorimi gjerësisht i formateve në Excel, për të mbajtur regjistrime të parave në arkat për veprim dhe stok. Kartëmonedhat të cilat janë emetuar më parë dhe më pas janë rikthyer në arkë dhe janë paketuar nga punonjësit e Bankës, mbajnë etiketa vetëm me datën e paketimit, por pa një numër serial identifikimi, duke reflektuar një risk të lartë për tu monitoruar gjatë këtij procesi.

-Nuk ka praktika të njëjta lidhur me kufirin maksimal për gjendjen e parave të mbajtura në arkën qendrore për veprim, dhe për paratë e mbajtura nga degët.

-Ka nja nivel të lartë kartëmonedhash të paemtuara, të cilat janë printuar në vitet e mëparshme. Përafërsisht 43% të gjendjes aktuale, i takon kartëmonedhave të printuar midis viteve 2007 dhe 2012.

-Është evidentuar mungesa e kontroleve të përshtatshme mbi gjendjen e parasë dhe qarkullimin e saj, si dhe e një metodologjie të mirëpërcaktuar në lidhje me këtë qarkullim, duke reflektuar rrezikun e qarkullimit të ulët të kartëmonedhave dhe duke ekspozuar bankën ndaj një rreziku më të madh të përvetësimit.

-Kushtet fizike të arkave janë vlerësuar jo të përshtatshme, që mund të dëmtojë aftësinë e personelit për të kryer procedura kontrolli në kohë e të përshtatshme dhe kontrole të vazhdueshme mbi gjendjen e parave të mbajtura në këto vendndodhje.

-Mungesa e procedurave të rotacionit të detyrueshëm të personelit përgjegjës për vlerat monetare për të minimizuar rrezikun e bashkëpunimit në mashtrim që rrjedh nga një numër i vogël i punonjësve të përfshirë në proces.

Për sa më sipër rekomandoj:

Në iniciativën ligjore të iniciuar të vlerësohet kërkesa për ndryshimeve në plotësimin e nenit 40 të Ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, lidhur me kontrollin mbi paranë, plotësime të cilat duhet të gërshetojnë në mënyrë efektive jo vetëm praktikën bazuar në rregullat që normojnë këtë proces në Bankën Qendrore Evropiane dhe vendeve të Eurozonë por edhe kontekstin, kulturën dhe sistemet mbi të cilën realizohet ky proces në Shqipëri.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Nga auditimi u konstatua se për herë të parë Banka e Shqipërisë ka bërë mbylljen e pasqyrave financiare në mbështetje të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, fakt që ka sjellë edhe veprime rregulluese me efekte të rëndësishme si në gjendjet e llogarive në çelje dhe në rezultatin e vitit 2015, për shkak të tranzicionit drejt SNRF. *Veprimet rregulluese në Librin e Madh (Gl) dhe në sistemin e Fix Asset sipas politikave të reja kontabël për efekt të tranzicionit në SNRF kanë patur një efekt në 9,840,320 lekë për vitin 2014 dhe 11,128,320 lekë për vitin 2015. Kështu nga:*

A. Çregjistrimi i kuotizacioneve

Çregjistrimi i kuotizacioneve nga bilanci i Bankës së Shqipërisë duke filluar nga 1 Janari 2014, për **kuotizacionet në monedhën (Lekë)**, në pozicionin financiar më 31 dhjetor 2014, zëri ku kanë qenë të përfshira kuotat, është zvogëluar për 334,882,061 lekë dhe është prekur rezerva e tranzicionit për 334,882,061.00 lekë.

Për pjesëmarrjen në Bankën Botërore (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) nga sistemi pas rivlerësimit të valutave për datën 31 dhjetor 2015, rezulton një zvogëlim i rezervës së vlerësimit nga valutat prej 10,248,809 lekë. Efekt total është shpërndarë në pasqyrën e pozicionit financiar për llogarinë e rivlerësimit nga valutat për vitin 2014 ka

zvogëlim me 4,809,637 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

Për pjesëmarrjen në IDA (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim) nga sistemi pas rivlerësimit të valutave për datën 31 dhjetor 2015, rezulton një zvogëlim i rezervës së vlerësimit nga valutat prej 790,486 lekë. Efekti total prej 790,486 lekë do të shpërndahet në pasqyrat financiare si më poshtë: në balancën e llogarisë së rivlerësimit nga valutat për vitin 2014 ka zvogëlim me 370,965 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

Për pjesëmarrjen në MIGA (Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe). Gjatë vitit 2015, Banka ka kryer një regjistrim kontabël për efekt të kuotave për këtë institucion, i cili ka qenë anuluar disa vite më parë për kontabilizim të gabuar dhe nuk ishte regjistruar përsëri. Në vitin 1992 banka ka kryer regjistrimin kontabël për pagimin e kuotës në lekë për 7,844,500 Lekë në llogarinë rrjedhëse e hapur pranë Bankës së Shqipërisë (Kundërvlera në lekë e 78,445 USD e konvertuar me kursin USD =100 Lekë) si dhe për pagimin e shumës 47,067 USD. Në vitin 2005, pas një komunikimi me institucionin rezultoi që llogaria e MIGA-s pranë Bankës së Shqipërisë ishte kredituar për një shumë 6,275,600 lekë më shumë, nga pagesa e kuotave në lekë. Kjo teprice e konvertuar në USD duhet të ishte regjistruar si detyrim i njohur nëpërmjet emetimit të një note premtimi nga ana e Bankës së Shqipërisë. Pas dërgimit të mesazhit nga MIGA për debitim të llogarisë, Banka e Shqipërisë zvogëloi vlerën e kuotave në lekë me 6,275,600 Lekë dhe llogarinë rrjedhëse të institucionit për të njëjtën vlerë, ndërkohë që kundërvlera në USD e kësaj shume (62,756 USD) duhej të regjistrohej si kuotë në valutë përkundrejt llogarisë së letrave me vlerë të këtij institucioni. Në kuadër të tranzicionit në SNRF, pasi u shqyrtua gjithë dokumentacioni pranë BSH, u regjistrua si kuotë në USD shuma 62,756 USD dhe u hap një llogari e re pasivi, llogari e letrave me vlere të MIGA me Nr. 338102. Pas këtij veprimi kuotat në valutë rezultojnë 109,823.00 USD.

Nga sistemi pas rivlerësimit të valutave për datën 31 dhjetor 2015 rezulton një zvogëlim total i rezervës së vlerësimit nga valutat prej 3,128,857 lekë. Efekti total prej 3,128,857 lekë shpërndahet në pasqyrat financiare për vitin 2014 ka zvogëlim me 1,468,333 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

Për pjesëmarrjen në IFC (Korporata Financiare Ndërkombëtare) nga sistemi pas rivlerësimit të valutave për datën 31 dhjetor 2015, rezulton një zvogëlim i rezervës së vlerësimit nga valutat prej 20,968,640 lekë. Efekti total prej 20,968,640 lekë shpërndahet në pasqyrat financiare për vitin 2014 ka zvogëlim me 9,840,320 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

Për pjesëmarrjen në EBRD-në (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) nga sistemi pas rivlerësimit të valutave për datën 31 dhjetor 2015, rezulton një zvogëlim i rezervës së vlerësimit nga valutat prej 16,624,057 lekë. Efekti total prej 16,624,057 lekë shpërndahet për vitin 2014 ka zvogëlim me 7,801,461 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

Për pjesëmarrjen në IDB (Banka Arabe e Zhvillimit) nga sistemi pas rivlerësimit të valutave për datën 31 dhjetor 2015, rezulton një zvogëlim i rezervës së vlerësimit nga 6,552,700 lekë. Efekti total prej 6,552,700 lekë shpërndahet në pasqyrat financiare për vitin 2014 zvogëlim me 3,075,100 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

B. Çregjistrimi i rivlerësimit të Argjendit dhe Arit dhe Platinit në kasafortën e Bankës së Shqipërisë dhe i Arit të pastandardizuar pranë Bankës së Anglisë.

Gjatë muajve janar 2015-nëntor 2015, llogaritë Ari dhe Argjendi në kasafortë janë rivlerësuar me kursin e tregut, sipas procedurave kontabël në fuqi. Ndryshimi i politikës kontabël për mbajtjen e këtyre llogarive në bilancin e bankës aktiv fiks me kosto të vlerësuar (deem cost) për datën 31 dhjetor 2014 shoqërohet me anulimin e veprimeve të rivlerësimit për vitin 2015. Efekti total prej 17,651,250 lekë shpërndahet për vitin 2014 ka zvogëlim me 1,151,525 lekë dhe pjesa që mbetet i takon 2015.

C. Regjistrimet kontabël për rivlerësimin e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara për efekt të tranzicionit në SNRF

Regjistrimet kontabël për procesin e rivlerësimit kanë konsistuar në:

-Çregjistrimin e vlerës së kategorive "Toka dhe ndërtime" para rivlerësimit si dhe disa zëra në kategorinë "instalime pajisje"

-Regjistrimin e vlerave të reja të kategorisë "Toka dhe Ndërtime" sipas raporteve të vlerësuesit të jashtëm

-Veprimet rregulluese me qëllim shtrirjen e efekteve të rivlerësimit duke filluar nga 01 janar 2015

-Mbylljen e efekteve neto të rivlerësimit në rezervën e rivlerësimit.

Regjistrimet për pasqyrimin e procesit të rivlerësimit të Kategorisë Toka dhe Ndërtime në regjistrat kontabël të Bankës së Shqipërisë janë konfirmuar dhe janë certifikuar nga audituesi i pavarur i cili ka dhënë opinionin për pasqyrat financiare të mbyllura në fund të vitit 2015. Për shkak të kalimit për herë të parë nën SNRF, opinionin e një audituesi me eksperiencë ndërkombëtare është i domosdoshëm për shkak të nivelit të njohjes dhe thellimit mbi standardet e raportimit financiar në Banka, dhe veçanërisht ato qendrore që kanë aspekte teknike specifike, mbi të cilat audituesit e KLSH e kanë të vështirë të shprehen.

D. Konstatohet se në pasqyrat financiare të BSH të vitit 2015, që janë dhe pasqyrat e para financiare në përputhje të plote me SNRF, balancat për fundin e vitit 2014 dhe datën e tranzicionit 01.01.2014 janë përgatitur në përputhje me SNRF dhe balanca e fondit të pensionit është paraqitur në zërin "Depozita dhe kredi nga palë të treta" në vlerën 31 milionë lekë. **Fondi i pensionit të punonjësve të BSH** është identifikuar, klasifikuar dhe kontabilizuar si plan me kontribute të përcaktuara në përputhje me SNK 19. Detyrimi ndaj fondit të pensionit lidhet me fondin e pensionit që bazohet në kontributin e punonjësve si dhe në kontributin e punëdhënësit. Mbështetur në vendimin Nr.17, datë 26 shkurt 2014 të Këshillit Mbikëqyrës, fondi i pensionit raporton pozicionin e tij financiar më vete nga ai i Bankës së Shqipërisë, megjithatë nuk ka një aneks në pasqyra që të reflektojë aktivitetin vjetor të këtij fondi, pasi pozicioni financiar nuk reflekton shumë lidhur me transparencën e investimit dhe të administrimit të tij, trajtuar më hollësisht në faqen 44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Në përputhje me praktikën e raportimit në Bankat Qendrore, nga ana e Bankës duhet të hartohet një guidë referuar Standardeve të mundshme për tu aplikuar në rastin e Bankës së Shqipërisë dhe atyre të cilat nuk duhet të aplikohen kjo për të ndihmuar në transparencën por dhe konsistencën e Raportimit Financiar në këtë Institucion të rëndësishëm. Lidhur me rekomandimet e audituesit të jashtëm për të rritur vëmendjen ndaj stafit të kontabilitetit dhe një ndarje më të drejtë të fushave që mbulojnë jemi plotësisht në të njëjtin mendim. Cilësia e Raportimit financiar është e rëndësishme për të vlerësuar edhe mënyrën e operimit të këtij institucioni, në këtë kontekst edhe investimi në programe të integruar të kontabilitetit do të ishte vlerë e shtuar në këtë drejtim.

Të analizohet përgjegjësia në rastin e diferencës së konstatuar mbi kuotizimin të MIGA (Agjencia e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe).

Menjëherë

4. Nga auditimi i procedurave të prokurimit ka rezultuar që në vendimin nr.81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për miratimin e Rregullores "Për procedurat e Prokurimit në Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 49, përcaktohen kompetencat e

Komisionit të Prokurimit si: “a.Përcakton dhe vendos mbi ndarjen në lote të objektit të prokurimit kur çmohet e nevojshme; dokumentet e tenderit ose të ftesës për kuotim që do t’u shpërndahen kandidatëve; specifikimet teknike; kriteret e vlerësimit; kualifikimin e kandidatëve; vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave ose të kuotimeve dhe përzgjedhjen e asaj fituese”.

Pra, Komisioni i Prokurimit përcakton dhe vendos mbi dokumentet e tenderit dhe njëkohësisht bën edhe vlerësimin e ofertave.

Konstatohet se për periudhën objekt auditimit janë kryer rreth 150 raste të blerjeve me vlera të vogla për furnizim me mallra, materiale dhe shërbime të ndryshme, ndër të cilat përmendim 21 raste janë blerë 43 tonera për printer dhe fotokopje me procedurë blerje me vlera të vogla në 4 subjekte të ndryshme [REDAKTUAR]. Procedura për këto blerje është kryer me testim çmimi në tre subjekte private të ndryshme nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla. Kjo mënyrë prokurimi është copëzim fondesh, pasi në zbatim të vendimit nr.81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë” ndryshuar me vendimin nr.78, datë 19.11.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, duhej të llogariteshin nevojat për gjithë periudhën me qëllim kryerjen e procedurave prokuruese konform nenit 2 të kësaj rregullore, ku është përcaktuar “Qëllimi dhe parimet”, pika 1. Germa “c” Parimi i nxitjes së konkurrencës në prokurim nëpërmjet kandidatëve për furnizimin me mallra, për ndërtime ose për shërbime dhe që plotësojnë nevojat dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë në sasi, cilësi e kohë, dhe pika “ç” Parimi i sigurimit të përfitimeve maksimale për Bankën e Shqipërisë.

Kryerja e procedurave të prokurimit nëpërmjet testimit të tregut (përmes tre ofertave) megjithëse është korrekte referuar bazës rregullative, rezulton jo efektive pasi për realizimin e blerjeve dhe shërbimeve Departamenti i Administrimit, angazhon 3 nëpunës gjatë gjithë vitit që merren me studime tregu, të cilat janë larg një metodologjie të saktë të përcaktimit të kostos, *trajtuar më hollësisht në faqet 55-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Me qëllim rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit të fondeve publike të Bankës së Shqipërisë, propozojmë që Këshilli Mbikëqyrës të bëjë ndryshime në vendimin 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e Rregullores “Për procedurat e Prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke përcaktuar si kompetencë për Komisionin e Prokurimit vetëm vlerësimin e ofertave, ndërsa dokumentet e tenderit të hartohen nga Sektori i Prokurimit dhe të miratohen nga Zv.Guvernatori që mbulon administrimin. Ndryshimet duhet të përshtaten edhe me përcaktimet e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika 11, me qëllim orientimin e blerjeve të vlerave materiale dhe shërbimeve drejt prokurimit elektronik, jo vetëm për përdorim efektiv të burimeve njerëzore, por edhe nxitjes së konkurrencës në prokurim nëpërmjet kandidatëve për furnizimin me mallra, e shërbime në cilësi e kohë, me qëllim të sigurimit të përfitimeve maksimale nga aktiviteti administrativ i Bankës së Shqipërisë.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Nisur nga konstatimi se nuk është proceduar në drejtim të punimeve për godinën “Ish Hotel Dajti”, fakt ky që lidhet jo vetëm me mos vënie në efincencë për një kohë të gjatë të një investimi të pamenduar mirë, por edhe me efekte në buxhetet operative të Bankës së Shqipërisë, e vlerësojmë të rëndësishme të sjellim në vëmendje të Këshillit Mbikëqyrës dhe të vetë drejtimit

të Bankës, se në zbatim të vendimit nr.108, datë 09.09.2014 të Kryetarit të KLSH-së “Për evadimin e materialeve të auditimit të ushtruar në Bankën e Shqipërisë "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, zbatimi i buxhetit dhe rregullshmëria e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit dhe obligacioneve”, në lidhje me mospërfundimin e projektit për objektin “Rikonstruksioni i ish godinës së "Hotel Dajti", Banka e Shqipërisë” dhe pasojave me efekte negative ekonomike që sjell mosdorëzimi në kohë e këtij projekti, kemi kërkuar

- *Të analizohet edhe njëherë situata nga niveli drejtues dhe të gjitha masat e mundshme për të rikuperuar kohën e tejkaluar në këtë projekt, kohë që përkthehet në kosto qiraje për rezultatin e Bankës por edhe të shikohet mundësia që kostoja shtesë, në gjykimin tonë jo plotësisht e arsyetuar, të rikuperohet duke mos tejkaluar nivelin e parë të vlerës së planifikuar për të realizuar këtë rikonstruksion.*

- *Duhet të vlerësohet kostoja oportune e pagesave të qirasë të cilat vazhdojnë të paguhen nga Banka e Shqipërisë, ndërkohë që për kohën e shtyrjes së kontratave kjo kosto duhet t'i ngarkohet sipërmarrësit që nuk ka realizuar në kohë projektin ose nëse janë fajtorë persona brenda BSH-së, të përcaktohen këto përgjegjësi që efekti të mos rëndojë në rezultatin e Bankës (rekomandim i përsëritur nga viti i kaluar).*

Nga auditimi i materialeve të vëna në dispozicion konstatohet se si pasojë e procedurave burokratike ndërinstitucionale midis Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Kulturës, Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe Bashkisë së Tiranës për marrjen e lejes së ndërtimit, nuk ka filluar ende procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i ish godinës së Hotel Dajti, Banka e Shqipërisë”, objekt që do të shërbente për sistemimin e personelit të Bankës së Shqipërisë që sot zhvillon aktivitetin në kompleksin “X”. Banka e Shqipërisë prokuron çdo vit procedurën me objekt “Marrje me qira e ambienteve në kompleksin “X”, i cili vetëm për vitin 2015 i ka kushtuar buxhetit të Bankës së Shqipërisë 70,061,388 lekë (5,838,449 lekë/muaj).

Për sa më sipër rirekomandoj:

Banka e Shqipërisë të marrë të gjitha masat që të nxisë përfundimin e procedurave burokratike për sigurimin e dokumentacionit teknik (lejen e ndërtimit) nga strukturat përgjegjëse, me qëllim fillimin e procedurave të prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i ish godinës së Hotel Dajti, Banka e Shqipërisë” dhe shmangien e pagesave të ambienteve të marra me qera, të cilat rëndojnë në mënyrë të konsiderueshme buxhetin e Bankës së Shqipërisë.

Menjëherë

2. Nga auditimi i programimit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe realizimit të tyre, konstatohet se, të ardhurat e programuara kanë një trend rënës nga viti në vit, kështu për vitin 2015 të ardhurat janë programuar 21 % më pak se në vitin 2014, ndërsa shpenzimet për vitin 2015, janë programuar në shumën prej 3,813,107 milion lekë ose 8 % më pak se viti 2014. Si pasojë e këtij programimi edhe fitimi i Bankës së Shqipërisë për vitin 2015 është parashikuar 75,903 mijë lekë, ose 18 herë më pak se fitimi prej 1,349,823 mijë lekë i realizuar në vitin 2014. Për vitin 2015 fitimi është realizuar 1,894,921 mijë lekë ose rreth 25 herë më tepër krahasuar me planin.

Nisur nga fakti që auditimi i të ardhurave është një proces i vështirë dhe kërkon kapacitete që njohin mirë kontabilitetin bankar dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, si dhe faktin që është një aspekt që monitorohet dhe vlerësohet nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare të specializuara në këtë drejtim, misionet tona të auditimit fokusohen në rregullshmërinë e shpenzimeve të aktivitetit (kryesisht ato operacionale).

Nga auditimi rezultoi se **për vitin 2015**, shpenzimet në total janë realizuar 3,153,049 mijë lekë me një ulje krahasuar me planin prej 660 mijë lekë, ndërsa, krahasuar me vitin 2014 shpenzimet janë ulur në masën 1,002 mijë lekë. Për këtë vit, fitimi i miratuar për tu derdhur në buxhetin e

shtetit “Depozite qeverie” është 1,091 milionë lekë, pra më pak për 259 milion lekë, ose rreth 20% më pak se një vit më parë. Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.25, datë 02.03.2016 “Për miratimin e pasqyrës së pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë dhe shpërndarjes së fitimit neto”, është bërë miratimi i pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raporimit Financiar për vitet 2014 dhe 2015 dhe është *miratuar e ardhura neto nga aktiviteti i Bankës së Shqipërisë për vitin 2015, në masën 1,891 milion lekë*, fitim i rezultuar nga të ardhurat neto nga aktiviteti i bankës, pasi zbriten provigjone të llogaritura për borxhe të dyshimta dhe pa shpresë arkëtimi. Në pikën 5 të këtij vendimi, është miratuar veçimi i vlerës prej 800 milion lekë, si “rezervë e veçantë e Bankës së Shqipërisë”, duke mos përcaktuar në këtë pikë, bazën ligjore dhe domosdoshmërinë e krijimit të kësaj rezerve të veçantë, trajtuar më hollësisht në faqet 33-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Këshilli Mbikëqyrës të ketë në vëmendje nivelin e fitimit që Banka e Shqipërisë duke monitoruar në mënyrë të vijueshme si nivelin e të ardhurave por dhe të shpenzimeve për të ruajtur një nivel të caktuar të fitimit që shkon në buxhetin e shtetit. Të merren masa për të përcaktuar rregulla specifike për domosdoshmërinë e krijimit të “rezervës së veçantë” për Bankën e Shqipërisë.

Menjëherë

3. Nga auditimi i shpenzimeve administrative të cilat për vitin 2015 rezultuan në 3,153,049 mijë lekë dhe me një ulje të ndjeshme krahasuar me nivelin prej 4,155,117 lekë të një viti më parë, u konstatuam disa problematika;

a. Me Urdhër shpenzimi nr.725, datë 06.02.2015 është likuiduar shoqëria Kanadeze [REDAKTUAR] me objekt “Rishtypjen e monedhave metalike” sipas kontratës nr. 1836, datë 03.12.2013, respektivisht:

Monedha metalike me kurs ligjor 1 lek në sasinë prej 15,000,000 copë me vlerë 344,000 USD me përbërje Cu-Zn me peshë 3,0 gr/copë.

Monedha metalike me kurs ligjor 10 lekë në sasinë prej 15,000,000 copë në vlerën 430,000 USD me peshë 3.6 gr/copë.

Sipas këtyre të dhënave konstatohet se, monedhat kanë të njëjtën përbërës aliazhi metalik Cu-Zn. Monedhat metalike me kurs ligjor **10 (dhjetë) lekë** janë 0.6 gram më tepër se prerja e monedhës metalike me kurs ligjor **1 (një) lek**. Në këtë rast, pesha e monedhës me kurs ligjor 10 lekë është 20 % më e madhe se monedha me prerje 1 lek, ndërsa kosto e prodhimit të tyre nuk shkon sipas këtij raporti por kosto e prodhimit të monedhës me kurs 10 lekë, është 0.05 % më tepër se kosto e monedhës me kurs ligjor 1 lekë. Monedhat me kurs ligjor 1 lek, qarkullojnë vetëm në rrjetin tregtar të supermarketeve për kthim resto ndaj blerësve vetën për një xhiro dhe më pas nuk rikthehen më në qarkullim, për shkak të numrit të madh që ka nënfishi i tyre në raport me monedhat e prerjeve të tjera respektivisht 1/10, 1/100, 1/1000, trajtuar më hollësisht në faqet 50-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për sa më sipër rekomandoj:

Në zbatim të përdorimit efektiv të fondeve publike dhe ligjit të Bankës së Shqipërisë, Departamenti i Qarkullimit Monetar të marrë masa për të parashikuar politika të tjera monetare për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, me qëllim eliminimin e prodhimit të monedhave metalike me kurs ligjor 1 lekë që nuk rikthehen në qarkullim, duke rritur artificialisht sasinë e parasë në qarkullim dhe koston e prodhimit të tyre.

Menjëherë

b. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se, në mënyrë periodike më kërkesa të stafit drejtues është blerë “Ujë natyral” në sasinë prej 1,480 copë (shishe qelqi), me procedurë blerje me vlera të vogla, nëpërmjet testimit të tregut me çmimin 70 lekë/shishe 0.25 litra ujë “█ nga shoqëria “█” Tiranë. Blerja e këtij produkti duke specifikuar masën dhe ambalazhin ka paracaktuar blerësin, në kundërshtim me vendimin nr.81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë” ndryshuar me vendimin nr. 78, datë 19.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, pika 1. Germa “c” Parimi i nxitjes së konkurrencës në prokurim nëpërmjet kandidatëve për furnizimin me mallra, *trajtuar më hollësisht në faqen 51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Marrjen e masave për krijimin e një terreni të favorshëm për stimulimin dhe promovimin e produktit vendas, jo vetëm për cilësinë por edhe për çmimin e favorshëm krahasuar me ujin e importit.

Menjëherë dhe në vijimësi

c. Nga auditimi konstatohet se për vitin 2015 janë kryer procedura prokurorese për blerje karburanti për nevojat e BSH, në vlerën totale prej 34,515,850 lekë. Në kriteret e vlerësimit dhe termat e referencës së hartuara nga Departamenti i Administrimit është përcaktuar çmimi më i ulët në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë tregtimin dhe tenderimin e karburanteve në Shqipëri. Nga auditimi i procedurave të prokurimit ka rezultuar që në disa raste është shmangur Rregullorja e Prokurimit, neni 35 “Kërkesat për kualifikimin e kandidatëve”, duke mos vendosur kriterin për “Kontratat e ngjashme dhe të përafërta”.

Për sa më sipër rekomandoj:

c.a. Departamenti i Administrimit të marrë masa të menjëhershme që në procedurat e ardhshme për blerje karburant, programimi i fondit limit të bëhet duke marrë në referencë kategorinë e këtij produkti, i cili është i kuotuar në bursë dhe ka kosto reference (çmim + tarifa doganore + taksa). Nëpërmjet këtij kriteri furnizimi me *karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, dhe - marzhin e fitimit, të shprehur në vlerë absolute dhe në përqindje.*

Nëpërmjet kësaj mënyre do të minimizohet mundësia e abuzimit me përllogaritjen e fondit limit dhe me marrëveshjet e fshehta ndërmjet operatorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

c.b. Nga ana e Komisionit të Prokurimit, për të arritur përzgjedhjen e kandidatëve më të besueshëm nga ana tekniko-ekonomike, të merren masa për zbatimin e Rregullores së Prokurimit në lidhje me kontratat e ngjashme dhe të përafërta, duke përcaktuar edhe vlerën e kontratës që kandidati duhet të ketë realizuar.

Menjëherë

d. Nga auditimi u konstatua se në ambientet e punës së godinës së re të Bankës së Shqipërisë është ndërtuar dhe inauguruar salla e konferencave me kapacitet rreth 100 persona, ndonëse kjo sallë është e pajisur me aksesore dhe teknologjinë elektronike të kohës në vlerën 29,700,000 lekë, e cila ka funksion organizimin e vidiokonferencave të ndryshme Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 2015 konferencat dhe aktivitetet periodike i ka zhvilluar në disa subjekte private, për të cilat ka paguar shpenzime qira objekti, foni e ndriçim në shumën totale prej 675,200 lekë,

kështu: Me urdhrin nr. 3807, datë 22.06.2015 është organizuar forumi “Albania Financial forum III” me pjesëmarrjen 55 personave në ■■■■■, duke paguar qira salle në shumën prej 140,000 lekë; me urdhrin nr. 5370, datë 26.10.2015, është organizuar “ Workshop datë 05.10.2015 në hotel ■■■■■ me pjesëmarrjen e 50 personave, për të cilën është paguar qira salle për ½ ditë në shumën prej 75.600 lekë, shpenzime projektori 14,000 lekë fonia 14,000 lekë; me urdhrin nr. 5086, datë 07.10/2015, janë likuiduar shpenzime qira salle foni e ndriçim në hotel ■■■■■ në shumën 174,762 lekë, për marrje me qira të një salle në ■■■■■ me objekt “Për organizimin e tryezës ekonomia dhe bankat, sfidat për të ardhmen midis BSH dhe qeverisë shqiptare dhe përfituesve të sistemit bankar në RSH, për të cilën është paguar qira salle për ½ ditë 78 mijë lekë me pjesëmarrjen e 37 personave, si dhe shpenzime, foni ndriçim, në shumën 14,000 lekë.; me urdhrin nr. 5761, datë 17.11.2015 janë kryer pagesa për organizimin e konferencës vjetore “A ndryshojnë krizat themelet ekonomike në vendet e Europës juglindore” organizuar në datën 30.10.2015, për të cilën janë paguar shpenzime për qira objekti, në ■■■■■”, për të cilën janë paguar shpenzime në shumën prej 353,600 lekë, qira salle, sistem fonie, ekrane projektimi dhe ndriçim, *trajtuar më hollësisht në faqen 52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Banka e Shqipërisë të marrë masat e nevojshme për përshtatjen e sallës së video konferencave sipas natyrës së mbledhjeve dhe workshop-eve që realizohen me qëllim jo vetëm shfrytëzimin e kapaciteteve të ambienteve për të cilat janë shpenzuar vlera të konsiderueshme monetare, por edhe përdorimin efektiv të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

e. Për periudhën objekt auditimi BSH ka likuiduar faturat e paraqitura nga “INSTAT” sipas kontratës nr. 3953, datë 13.08.2015 në vlerën prej 20,176,000 lekë me objekt “Kryerja e vrojtimit dhe sigurimi i informacioneve statistikore për vrojtimin në terren nëpërmjet pyetësorëve për; ndërtimin e shërbimeve të biznesit, vrojtimi i besimit të konsumatorit, vrojtimi i turizmit, vrojtimi i të ardhurave nga emigrantët, vrojtimit për borxhin e korporatave në Shqipëri, vrojtimit për pasuritë e paluajtshme, vrojtimit për borxhin e familjeve dhe vrojtimit për investimeve të huaja. Nga verifikimi i kryer në treguesin me emërtimin “Investime të huaja direkte” konstatohet se: Në tremujorin e IV 2014 në Tiranë ushtrojnë aktivitet 137 Ndërmarrje me investime të huaja, nga këto 92 aktive 3 janë të mbyllura 7 të fjetura, nga këto 19, prej tyre refuzojnë të japin informacion,

Për 3/mujorin e parë 2015, në Tiranë janë evidentuar 142 ndërmarrje, ose 5 ndërmarrje më tepër. Për këtë ndryshim nuk ka asnjë shpjegim në një kolonë të veçantë ku të evidentohet ne se ka shtesa, tregues këto që pasqyrojnë të dhëna të pasakta midis dy periudhave. Gjithashtu nga këto ndërmarrje 19 prej tyre në vitin e kaluar kanë refuzuar të përgjigjen për treguesit statistikore, ndërsa për tremujorin e parë numri i tyre që refuzojnë është shtuar në 25 ndërmarrje.

Në Durrës janë 17 ndërmarrje me investime të huaja ndërsa në vazhdim në tremujorin e parë të vitit 2015 sipas evidencës kanë aktivitet 15 ndërmarrje me investime të huaja. Për këtë ndryshim nuk ka asnjë të dhënë midis 17 ndërmarrjeve me investime direkte që ishin vitin e kaluar dhe uljes së numrit të tyre për vitin 3/m e parë 2015.

Në Berat në tremujorin e IV të vitit 2014 paraqiten aktive 2 ndërmarrje me investime të huaja, ndërsa në tremujorin e parë të vitit 2015 këto ndërmarrje janë përsëri aktive por ndryshe nga tremujori i IV i vitit 2014 njëra prej tyre refuzon të japë informacion ndërkohë që para tre muajve ka dhënë informacion, për këtë nuk ka asnjë shpjegim për informacionin që kërkohet dhe shkaqet e mosdeklarimit.

Nga auditimi konstatohet se në formatin “Letër për Drejtimin Hartuar nga Kompania Auditese e përzgjedhur, me objekt “Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2015” në kapitullin III “Menaxhimi i vijueshmërisë së biznesit”, evidentohet se Kuadri Rregullues bazohet në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.97, datë 26.11.2003 “Parimet e përgjithshme për administrimin e situatave emergjente”. Pavarësisht disa ndryshimeve të mëvonshme, kjo kornizë nuk është përditësuar rregullisht për të reflektuar kushtet aktuale të Bankës, ato nuk përmbajnë detaje të vazhdueshmërisë së biznesit dhe procedurat e rimëkëmbjes në rast fatkeqësie dhe as udhëzime për rivendosjen e sistemeve kritike. Banka nuk ka një proces të përcaktuar qartë të dokumentuar dhe të miratuar që do të drejtojë Menaxhimin e vijueshmërisë së biznesit dhe të dokumentojë procesin në lidhje me krijimin e aktiviteteve kritike të biznesit ndërvarësisë dhe ndikimit të përbërjes së tyre. Kuadri ekzistues nuk mbështet zonat e rrezikut të rëndësishëm dhe as parasheh një proces standard në lidhje me vlerësimin e rrezikut në nivel të Bankës

Nga verifikimet e kryera konstatohet se Banka e Shqipërisë ka kryer pagesa në shumën 45,900 lekë edhe për subjektet që refuzojnë të japin informacion, në këto kushte vrojtuesit statistikorë të kontraktuar nga “INSTAT-i” nuk kanë përmbushur detyrën konform ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit publik”, ndërkohë që këto shoqëri janë të detyruara t’u përgjigjen kërkesave që ka formuluar BSH dhe në rast refuzimi në zbatim të kreut V, “Shkeljet dhe sanksionet administrative” neni 18 “kundërvajtjet administrative refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me gjobë nga 150,000 deri në 300,000 lekë, pasi pyetësorët e kërkuara nga BSH kanë të bëjnë me tregues ekonomikë dhe shoqërorë dhe refuzimi për të dhënë përgjigje, tregon së këto shoqëri fshehin të dhënat, *trajtuar më hollësisht në faqet 52-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Në kontratat në vazhdimësi krahas detyrimeve të palëve të vendoset edhe një nen i veçantë si kusht që, në rast mosdhënie të informacionit ndaj vrojtuesve të “INSTAT-it” të aplikohen sanksione ligjore konform ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit publik”.

Menjëherë dhe në vijimësi

f. Në tenderin me objekt “Sistemim i trotuareve dhe rrugëve përreth godinës së Bankës së Shqipërisë” është përcaktuar fondi limit sipas kategorive të punimeve dhe jo i detajuar me zëra punimesh, duke mos respektuar:

a. Udhëzimin nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin dhe strukturën e koston se punimeve të ndërtimit”.

b. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”,

c. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 664, datë 26.9.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

Ka patur një rritje fiktive të preventivit në vlerën **6,994,783.90 lekë** pa t.v.sh për shkak të mospërdorimit të çmimeve të manualit, si dhe janë hartuar preventiva të padetajuar (a forfait) në vlerën **14,250,000 lekë pa t.v.sh**, *trajtuar më hollësisht në faqet 57-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Spektori Teknik dhe Spektori i Prokurimeve në Departamentin e Administrimit, në zbatim të Vendimit nr. 81, datë 15.11.2006 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 51, të

analizojë dhe të kryejë përlllogaritjen e fondit limit të objekteve të ndërtimit bazuar në çmimet e përcaktuara në manualët e ndërtimit në fuqi dhe në analizat teknike të çmimeve sipas strukturës së përcaktuar në vendimet e sipër cituara ose aktve ligjore që mund të dalin në lidhje me to, me qëllim shmangien e rritjes fiktive të fondit limit.

Menjëherë dhe në vijimësi

g. Për objektin “Realizimi i lidhjes online ndërmjet ndërtesave të Bankës së Shqipërisë në Tiranë dhe asaj me degët si dhe shërbimi i brendshëm i rrjetit të transferimit të të dhënave, për një periudhë dy mujore” është përcaktuar procedura e prokurimit “Prokurim i drejtpërdrejt me [REDAKTUAR]”, bazuar në nenin 10, germa (f), “Për nevojë urgjente për mallra, për ndërtime ose për shërbime, e cila është shkaktuar nga rrethanat jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë dhe koha në dispozicion për zgjedhjen e nevojës urgjente nuk është e mjaftueshme për zhvillimin normal të procedurave të tjera të prokurimit, të parashikuara në këtë rregullore”, me fond limit për realizimin e këtij objekti në vlerën 10,0901,000 lekë.

Ky veprim është në kundërshtim me Vendimin Nr. 81, datë 15.11.2006 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, pasi AK për realizimin e kësaj procedure ka qenë në dijeni të plotë për përfundimin e kontratës paraardhëse në datë 06.02.2015 dhe ka patur kohën e mjaftueshme në dispozicion për të marrë veprimet e nevojshme për përcaktimin e specifikimeve teknike të shërbimit të internetit për vitin në vazhdim dhe për të zhvilluar një procedurë të hapur prokurimi. Realizimi i prokurimit nëpërmjet kësaj procedure, ka rezultuar me ulje të ofertës në krahasim me fondin limit me 8 lekë, *trajtuar më hollësisht në faqet 63-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Autoriteti Kontraktor të analizojë objektivisht rrethanat për përcaktimin e llojit të procedurës së prokurimit, duke shmangur, kur është e mundur, “procedurën e drejtpërdrejtë”, me qëllim përdorimin e procedurës së hapur, nxitjes së konkurrencës dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu Departamenti i Administrimit dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, për shërbimet e transferimit të të dhënave dhe të internetit, të përcaktojnë specifikimet teknike të paktën 3 muaj përpara përfundimit të kontratave ekzistuese, duke patur kohën e nevojshme për ndryshime në buxhet dhe marrjen e ofertave nga tregu për përcaktimin e shërbimeve që do të kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

h. Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Sigurimi i jetës dhe kujdesit shëndetësor për punonjësit e Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare**”, u konstatua se Komisioni i Prokurimit ka përzgjedh si ofertë fituese, ofertën e BOE [REDAKTUAR] me vlerën totale të primeve 227,350 lekë/person. Si kriter për vlerësimin ekonomik, Autoriteti Kontraktor (BSH) ka përcaktuar vlerën më e ulët e totalit të primeve/person të tre niveleve dhe fituese do të përzgjidhet ajo ofertë që ka fituar më shumë pikë në kriterin e vlerësimit të përcaktuar më sipër dhe jo me shumën e prodhimit të çmimit për secilën nivel me numrin e punonjësve përkatës, *trajtuar në faqet 70-73 të Raportit Përfundimtar.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Autoriteti Kontraktor për këtë lloj shërbimi të formatojnë një strukturë tjetër të dhënies së ofertës, duke konsideruar numrin e punonjësve të niveleve të ndryshme dhe çmim e primit për person. Vlera përfundimtare e ofertës të jetë sa shuma e prodhimit të çmimit për secilën nivel me numrin e punonjësve përkatës. Ndërsa në lidhje me çështjen e shtimit të punonjësve në skemën e sigurimit, BSH të konsiderojë numrin maksimal të punonjësve të cilët parashikohen të

shtohen, dhe në rastet kur nuk shtohen punonjës sipas parashikimit, të zbritet në faturën përfundimtare të kontratës vlera për çdo sigurim të pakryer.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA ZHDËMTIMI

1. Në mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2015, është bërë njohja e provigjoneve të rrjedhura nga proceset gjyqësore në të cilat BSH është palë në gjykim, në vlerën prej **46,768,036 lekë** (sipas urdhrit nr.298, datë 22.01.2016), **ku përfshihet detyrimi ndaj ish punonjësve të Bankës**; dhe disa kompanive të tjera, private dhe shtetërore për fatura fatura të palikuiduara qershor 2012-korrik 2013 dhe gusht-tetor 2015.

Për të gjithë vlerat monetare të mësipërme që kanë rënduar rezultatin e Bankës në fund të vitit 2015, nuk është nxjerrë asnjë përgjegjësi, madje duhet theksuar se; edhe ndaj shoqërisë ■■■■■ nuk është marrë asnjë masë për kryerjen e ndalesës për shumën **10,042,983 lekë**, e cila është përdoruese e ujit nga rrjeti hidrik i Bankës së Shqipërisë për rikonstruksionin e godinës qendrore, si dhe nuk është parashikuar asnjë nen të veçantë apo ndryshim i mëvonshëm në kontratë, në lidhje me ujin që shfrytëzohej nga shoqëria sipërmarrëse për ndërtimin e objektit. Sipas të dhënave kontabile kjo vlerë nuk është likuiduar nga shoqëria ndërtuese, ndërsa Ndërmarrja “Ujësjellës Kanalizime Tiranë”, ka paditur Bankën e Shqipërisë në gjykatë me objekt kthim shume. Për sistemimin e këtij veprimi BSH ka rënduar shpenzimet korrente në formën e provigjonimit por mungon përgjegjësia institucionale për këtë vlerë që ka dëmtuar fondet e Bankës, *trajtuar më hollësisht në faqen 54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për sa më sipër rekomandoj:

Kryerjen e veprimit kontabël për rimarrjen e vlerës prej **10,042,983 lekë**, dhe fillimin e një procesi gjyqësor ndaj shoqërisë “X” në cilësinë e sipërmarrësit për rikonstruksionin e Godinës së Bankës së Shqipërisë, për të kryer ndalesën nga garancia e zbatimit të punimeve për sa përfituar padrejtësisht nga ulja artificiale të kostos së punimeve nëpërmjet përdorimit të ujit nga rrjeti hidrik i institucionit pa dokumentuar dhe pa shlyer detyrimet ndaj UKT Tiranë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Në referencë të gjithë gjetjeve të këtij auditimi si dhe bazuar në adresimet e bëra në të, lidhur me aspekte të cilat kanë nevojë për ndërhyrje të menjëhershme por dhe të kujdesshme, i rekomandoj Guvernatorit dhe Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëjnë një analizë të plotë dhe të thellë për të përcaktuar përgjegjësitë administrative dhe financiare dhe për të gjykuar në mënyrë sa më racionale mbi masat që duhet të ndërmerren në përmirësimin e aspekteve të cënuara dhe të trajtuara në këtë Raport Auditimi.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R